



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

BORDI

VENDIM

Nr. 15, datë 27.02.2014

**PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT NR. 95, DATË 25.09.2013 “PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2014 PËR AUTORITETIN E MBIKËQYRJES
FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, neneve 124, 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Drejtorisë të Shërbimeve të Brendshme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Në pasqyrën nr. 5, shtojca nr. 3 të vendimit të Bordit nr. 95, datë 25.09.2013 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2014 për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, bëhen këto ndryshime:
 - a) Elementi II.10.29.3 “Lidhje data fiber optike me backup site” i zërit shpenzime administrative të TI pakësohet me 400 mijë lekë.
 - b) Elementi II.10.29.2 “Lidhje internet” i zërit shpenzime administrative të TI pakësohet me 230 mijë lekë.
2. Në Pasqyrën nr. 4, shtojca nr. 3 të vendimit të Bordit nr. 95, datë 25.09.2013 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2014 për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, bëhet ky ndryshim:
 - a) Zëri II.2.1 “Blerje pajisje dhe programe kompjuterike” i klasës Shpenzime Investimi shtohet me 630 mijë lekë.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Enkeleda SHEHI